Vendim nr. 320, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (V) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VASILLAQ SHKURTI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4123, datë 18.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i", e 2, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 28, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një ndër trashëgimtarët e shtetasit V.S., të cilëve, me vendimin nr. 421, datë 02.02.1996 *(vendimi nr. 421/1996)*, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave i Rajonit nr. 3 të Bashkisë Tiranë *(KKKP)* u ka njohur të drejtën e pronësisë për një truall me sipërfaqe 540 m^2, si dhe, për shkak se trualli ishte i zënë nga objekti kulturor shtetëror "Muzeu Historik Kombëtar", të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara nga neni 16 i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

2. Pas miratimit të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" *(ligji nr. 9235/2004)*, kërkuesi, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të trashëgimtarëve të tjerë, në datën 09.09.2008, i është drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qarkut Tiranë *(ZRKKP)* me kërkesë për kthimin e pronës së njohur me vendimin nr. 421/1996 të KKKP-së. Për shqyrtimin e kërkesës, ZRKKP-ja ka kërkuar informacion nga disa institucione shtetërore. Bashkia Tiranë ka bërë me dije se, sipas studimit të qendrës së Tiranës të miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.04.2004 të Këshillit të Rregullimit të Territorit *(vendim nr. 1/2004 i KRRT-së)*, prona përputhej plotësisht me gjurmën e një objekti me destinacion "institucion shtetëror" dhe pjesërisht me gjurmën e hapësirës në shërbim të institucionit shtetëror, gjurmën e objektit të propozuar 51.5 metra të lartë me destinacion "shërbime publike" dhe gjurmën e objektit të propozuar 9 metra të lartë. Ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që kishte në administrim Muzeun Historik Kombëtar, nuk ka dhënë informacion, pavarësisht kërkesave të përsëritura.

3. Po kështu, nga verifikimet në terren të kryera nga ZRKKP-ja ka rezultuar se nga sipërfaqja 540 m^2, e kërkuar për kthim fizik, 470 m^2 shtriheshin në sheshin dhe hapësirën në brendësi të Muzeut Historik Kombëtar, sipërfaqe e cila përkonte me objektin 51.5 metra të lartë të parashikuar në studimin e KRRT-së. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, me vendimin nr. 189, datë 26.06.2009 *(vendimi nr. 189/2009)*, ZRKKP-ja ka vendosur t'u kthejë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar pronën me sipërfaqe 470 m^2, sipas kufizimeve përkatëse.

4. Vendimi i ZRKKP-së i është komunikuar Avokaturës së Shtetit në datën 09.07.2009, ndërsa ankimi administrativ i paraqitur prej saj është regjistruar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës *(AKKP)* në datën 31.07.2009. Në kuadër të shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr. 935, datë 20.09.2011, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka pezulluar procedurën administrative deri në përfundimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 10308, datë

22.07.2010, që ndryshonte ligjin nr. 9235/2004. Pas vendimit nr. 43, datë 06.10.2011 *(vendimi nr. 43/2011)* të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me vendimin nr. 162, datë 21.03.2012, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka deklaruar mungesën e kompetencës dhe të juridiksionit të AKKP-së për shqyrtimin e ankimit të Avokaturës së Shtetit, duke u njohur palëve të drejtën për ta kundërshtuar vendimin në gjykatë brenda një afati ligjor 30-ditor nga njoftimi i tij.

5. Në datën 24.04.2012 Avokatura e Shtetit i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, në objektin e së cilës është shënuar kundërshtimi i vendimit nr. 213, datë 30.06.2009 *(vendimi nr. 213/2009)* të ZRKKP-së, ndërsa në përmbajtje dhe argumentet e padisë i është referuar vendimit nr. 189/2009 të këtij organi, të dhënë në favor të kërkuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 269, datë 22.01.2015, ka rrëzuar padinë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se studimi urbanistik i miratuar me vendimin nr. 1/2004 të KRRT-së parashikonte transformimin e sipërfaqes së kërkuar për kthim fizik dhe zhvillimin e saj përmes investimeve publike ose private në funksion të komunitetit. Ndërsa pretendimin e kërkuesit për parashkrimin e padisë gjykata e ka vlerësuar të pabazuar, me arsyetimin se nuk i përgjigjej realitetit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Avokatura e Shtetit.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 866, datë 15.04.2016, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë dhe anuluar vendimin nr. 189/2009 të ZRKKP-së. Sipas gjykatës së apelit, sipërfaqja prej 470 m^2 ndodhej brenda hapësirës së Muzeut Historik Kombëtar dhe vazhdonte t'i shërbente interesit publik, ndaj kthimi fizik i saj binte në kundërshtim me nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004 dhe nenin 5 të ligjit nr. 9386, datë 04.05.2005 "Për muzetë". Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se studimi urbanistik nuk kishte ndryshuar kushtet ligjore dhe faktike që kishin përligjur njohjen e së drejtës së kompensimit me vendimin nr. 421/1996 të KKKP-së, pasi prona vijonte t'i shërbente interesit publik dhe nuk mund të konsiderohej e lirë, sipas ligjit, për kthimin fizik. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4123, datë 18.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* sipas përmbajtjes së kohës. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se Avokatura e Shtetit kishte ndjekur fillimisht rrugën administrative, shqyrtimi i ankimit

ishte pezulluar nga AKKP-ja në pritje të vendimmarrjes kushtetuese dhe, më pas, kjo e fundit kishte deklaruar mungesën e juridiksionit administrativ. Sipas saj, ky vendim kishte natyrë procedurale dhe nuk mund ta kufizonte ngritjen e padisë në afatin ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 9235/2004, i cili zbatohej në rastet kur AKKP-ja ishte shprehur në themel për ankimin administrativ. Për rrjedhojë, e drejta e Avokaturës së Shtetit për të kundërshtuar në gjykatë vendimin e ZRKKP-së nuk kishte rënë në dekadencë. Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar edhe pretendimin e kërkuesit për natyrën jopublike të pronës, duke arsyetuar se sipërfaqja ishte pjesë e truallit funksional të Muzeut Historik Kombëtar dhe se studimet urbanistike për ndërtime të ardhshme nuk ndryshonin, në vetëve, regjimin juridik të saj si pronë publike.

8. Në datën 15.07.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi: i) ankimi administrativ është paraqitur nga Avokatura e Shtetit tej afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 9235/2004; ii) kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë nga Avokatura e Shtetit më shumë se 2 vjet nga paraqitja e ankimit administrativ. Neni 328 i KPC-së, sipas përmbajtjes së kohës, parashikonte mundësinë e paraqitjes së padisë edhe në rastet kur organi administrativ më i lartë nuk e shqyrtonte ankimin brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, kalimi i afateve ligjore kishte sjellë humbjen e së drejtës së Avokaturës së Shtetit për të kundërshtuar vendimin e ZRKKP-së në gjykatë. Paraqitja e padisë pas vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për deklarimin e mungesës së kompetencës dhe juridiksionit administrativ ka shërbyer si manovër procedurale për të fituar afatin e humbur.

9.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi: i) gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar në mënyrë të plotë pretendimet e tij për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i përgjithshëm dhe nuk i ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimit për zbatimin e nenit 328 të KPC-së dhe për pasojat juridike të mosrespektimit të afatit ligjor për ngritjen e padisë, respektimi i të cilit përbën parakusht për shqyrtimin e themelit të saj; ii) në vendimet gjyqësore, në pasqyrimin e objektit të padisë, është shënuar gabim vendimi nr. 213/2009 i ZRKKP-së, në një kohë kur kthimi fizik i pronës objekt gjykimi është vendosur me vendimin nr. 189/2009 të këtij organi.

9.2. *E drejta e pronës private*, si rrjedhojë e procesit të parregullt ligjor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare,

e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji do të ndalet në verifikimin e kriterit shterimit të mjeteve juridike efektive dhe në vlerësimin nëse pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve *(shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Kolegji evidenton se, ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë, në përmbajtje të kërkesës kërkuesi ka ngritur pretendime edhe ndaj vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta. Konkretisht, ai ka kundërshtuar pasqyrimin në vendimet gjyqësore të vendimit nr. 213/2009 të ZRKKP-së si objekt të padisë, në vend të vendimit nr. 189/2009 të këtij organi, me të cilin ishte vendosur kthimi fizik i pronës *(shih paragrafin 9.1.2., pika "ii", më sipër)*.

14. Kolegji vëren se kërkuesi nuk rezulton ta ketë parashtruar më parë këtë pretendim përpara gjykatave të zakonshme, duke mos dhënë atyre mundësinë për ta shqyrtuar dhe për ta korrigjuar, sipas rastit, parregullsinë e pretenduar. Për rrjedhojë, për këtë pretendim nuk është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim. Për pretendimet e tjera, të parashtruara në thelb përpara gjykatave të zakonshme, kërkuesi e plotëson këtë kriter.

15. Për sa i përket natyrës kushtetuese dhe bazueshmërisë së pretendimeve të tjera, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim *të parimit të sigurisë juridike* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *së drejtës së pronës*, të garantuara nga nenet 4, 41, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Kolegji konstaton se pretendimet për sigurinë juridike lidhen me afatet e ankimit administrativ dhe të padisë, ndërsa ai për arsyetimin e vendimit gjyqësor lidhet me përgjigjen e gjykatave ndaj kundërshtimit të afatit të padisë, përfshirë argumentin e mbështetur në nenin 328 të KPC-së. Për shkak të kësaj lidhjeje, Kolegji do t'i analizojë ato së bashku. Ndërsa pretendimi për të drejtën e pronës është mbështetur

në të njëjtat parregullsi procedurale dhe do të vlerësohet në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

16. Për sa i përket pretendimit për paraqitjen e ankimit administrativ jashtë afatit ligjor 30-ditor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe procedurat administrative. Kontrolli kushtetues synon të verifikojë respektimin e garancive të kësaj të drejte gjatë procedurës administrative dhe mbrojtjen e tyre nga gjykatat e zakonshme, të cilat, sipas parimit të subsidiaritetit, kanë përgjegjësinë parësore për këtë kontroll *(shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Në lidhje me procedurën e ankimit administrativ ndaj vendimeve të ZRKKP-ve, Kolegji konstaton se neni 18, pika 1, i ligjit nr. 9235/2004, i ndryshuar me ligjin nr. 9684, datë 06.02.2007, parashikonte, ndër të tjera, të drejtën e Avokaturës së Shtetit për të paraqitur ankim kundër vendimeve të njohjes të së drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të drejtave të tjera reale të zyrave rajonale të AKKP-së, brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit, në zyrën e AKKP-së në qendër.

18. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se vendimi nr. 189/2009 i ZRKKP-së, i datës 26.06.2009, i është komunikuar Avokaturës së Shtetit në datën 09.07.2009, ndërsa ankimi administrativ është regjistruar në AKKP në datën 31.07.2009, pra brenda afatit ligjor 30-ditor, i cili fillonte nga njoftimi dhe jo nga data e marrjes së vendimit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

19. Në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, Gjykata ka theksuar se e drejta për të kundërshtuar në gjykatë një akt administrativ nuk është e pakufizuar dhe se një nga kushtet ligjore që duhet respektuar është edhe afati i paraqitjes së padisë. Në rast të paraqitjes së padisë jashtë afatit ligjor, gjykatat nuk mund të investohen për shqyrtimin e çështjes *(shih vendimin nr. 4, datë 10.02.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*. Përcaktimi i afateve ligjore për mbrojtjen kushtetuese dhe ligjore të të drejtave dhe lirive të individit synon, ndër të tjera, garantimin e sigurisë juridike, miradministrimin e drejtësisë dhe shmangien e abuzimit me të drejtat *(shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese).* Për këtë arsye, respektimi i afatit ligjor për paraqitjen e padisë përbën parakusht për shqyrtimin nga gjykatat e zakonshme të themelit të mosmarrëveshjes *(shih vendimet nr. 18, datë 10.04.2025; nr. 26, datë 09.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Po kështu, Gjykata ka pohuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar garantohet për individin nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i tij është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 12, datë 18.03.2025; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëpërmjet arsyetimit të vendimit gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive *(shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr.18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk nënkupton dhënien e një përgjigjeje të detajuar për çdo pretendim të palëve, por ai duhet të përmbajë një përgjigje të mjaftueshme për pretendimet thelbësore dhe përcaktuese për zgjidhjen e çështjes (*shih vendimet nr. 69, datë 04.06.2026; nr. 35, datë 25.07.2011; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik i bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë *(shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket kuadrit ligjor të zbatueshëm, Kolegji vëren se neni 18, pika 1, i ligjit nr. 9235/2004, sipas përmbajtjes së tij në datën 31.07.2009, kur Avokatura e Shtetit ka paraqitur ankimin administrativ, parashikonte detyrimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për të vendosur për ankimin administrativ brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tij. Ky afat lidhej me shqyrtimin e ankimit administrativ dhe dallohej si nga afati për paraqitjen e tij, ashtu edhe nga afati për ngritjen e padisë në gjykatë. Më pas, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, neni 15, pika 1, shkronja "c", i ligjit nr. 9235/2004 parashikoi, ndër të tjera, detyrimin

e AKKP-së për të përfunduar shqyrtimin e ankimeve të depozituara nga Avokatura e Shtetit ndaj vendimeve të ish-zyrave rajonale brenda 3 muajve nga nisja e procedimit. Kjo dispozitë u shfuqizua si e papajtueshme me Kushtetutën me vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 *(vendimi nr. 27/2010)* të Gjykatës.

23. Ndërkohë, dispozitat ligjore që rregullonin kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shqyrtimin e vendimeve të organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave iu nënshtrua kontrollit kushtetues. Me vendimin nr. 27/2010, Gjykata shfuqizoi dispozitat që i njihnin drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së kompetenca për rishikimin dhe shfuqizimin në rrugë administrative edhe të vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale. Në vijim, për plotësimin e boshllëkut ligjor, kompetenca të ngjashme u parashikuan në ligjin nr. 10308, datë 22.07.2010, por edhe këto rregullime iu nënshtruan kontrollit kushtetues, në përfundim të të cilit Gjykata, me vendimin nr. 43/2011, vendosi shfuqizimin e neneve 2, 3 dhe 5 të këtij ligji, si të papajtueshme me Kushtetutën.

24. Për sa i përket ankimit gjyqësor, Kolegji vëren se neni 18 i ligjit nr. 9235/2004, i ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së padisë nga Avokatura e Shtetit, parashikonte se kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit kishte të drejtë të bënte ankim brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit, sipas rregullave të KPC-së. Nga ana tjetër, neni 15, pika 1, shkronja "b", paragrafi i dytë, i po këtij ligji përcaktonte se, pas shqyrtimit të ankimit administrativ, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së vendoste rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit ose shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes. Këto mënyra disponimi lidhen me shqyrtimin në substancë të ankimit.

25. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se krahas dispozitave të ligjit të posaçëm, afati për paraqitjen e padisë ndaj aktit administrativ rregullohej edhe nga neni 328 i KPC-së, i cili, sipas përmbajtjes së kohës, parashikonte se afati ligjor 30-ditor për ngritjen e padisë fillonte nga shpallja ose njoftimi i vendimit të organit më të lartë administrativ që kishte shqyrtuar ankimin, përveç rasteve kur ligji parashikonte ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Po kështu, në rastet kur organi administrativ më i lartë nuk e shqyrtonte ankimin brenda afatit ligjor, dispozita parashikonte të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës brenda afatit ligjor 30-ditor, edhe pa marrë përgjigje për ankimin administrativ. Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit mbështetet pikërisht në pasojat që, sipas tij, kishte sjellë mosushtrimi i padisë në këto kushte.

26. Ndërkohë, jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë ka trajtuar detyrimin e ndjekjes së rrugës administrative në çështjet e kthimit dhe të kompensimit të pronave, duke përcaktuar se pala e interesuar në procedurën administrative ose e prekur nga akti administrativ i dhënë në favor të një subjekti tjetër duhet të ndjekë fillimisht rrugën administrative për kundërshtimin e tij dhe, vetëm pasi të ezaurojë plotësisht atë, mund t'i drejtohet juridiksionit gjyqësor të zakonshëm *(shih vendimin nr. 2, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).* Më pas, me vendimin unifikues nr. 2, datë 21.01.2011, Kolegjet e Bashkuara kanë përcaktuar, ndër të tjera, se mosmarrëveshja në të cilën subjekti i interesuar kundërshton njohjen dhe kthimin e së njëjtës pronë një subjekti tjetër i përket juridiksionit gjyqësor. Këto qëndrime lidhen me përcaktimin e rrugës së kundërshtimit dhe duhen dalluar nga çështja e afatit të padisë në rrethanat konkrete.

27. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Avokatura e Shtetit ka paraqitur ankimin administrativ në datën 31.07.2009, ndërsa në datën 20.09.2011 drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të tij, në pritje të kontrollit kushtetues të ndryshimeve ligjore përkatëse. Në vijim të vendimeve nr. 27/2010 dhe nr. 43/2011 të Gjykatës, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, me vendimin nr. 162, datë 21.03.2012, ka deklaruar mungesën e kompetencës dhe të juridiksionit administrativ për shqyrtimin e ankimit. Më pas, Avokatura e Shtetit i është drejtuar gjykatës me padi për kundërshtimin e vendimit të ZRKKP-së, e regjistruar në datën 24.04.2012.

28. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se padia e Avokaturës së Shtetit ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, pretendim të cilin gjykata e ka vlerësuar të pabazuar me argumentin se nuk i përgjigjej realitetit, ndërsa ka vendosur rrëzimin e padisë në themel. Në vijim të ankimit të Avokaturës së Shtetit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin, duke pranuar padinë dhe anuluar vendimin nr. 189/2009 të ZRKKP-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke pretenduar, ndër tjera, paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor. Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim, me arsyetimin se vendimi i AKKP-së për deklarimin e mungesës së juridiksionit administrativ kishte natyrë procedurale dhe, si i tillë, nuk mund të kufizonte ngritjen e padisë në afatin ligjor 30-ditor të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, i cili zbatohej në rastet kur AKKP-ja ishte shprehur në themel për ankimin administrativ.

29. Në analizë të kësaj vendimmarrjeje, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar pretendimin e kërkuesit për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor dhe ka dhënë përgjigje të shprehur për shkakun e rrëzimit të tij. Konkretisht, ajo e ka mbështetur përfundimin në dallimin

ndërmjet vendimit që zgjidh në themel ankimin administrativ dhe vendimit me natyrë procedurale që deklaron mungesën e juridiksionit për shqyrtimin e tij. Në këtë drejtim, Kolegji mban parasysh edhe përmbajtjen e nenit 15, pika 1, shkronja "b", paragrafi i dytë, të ligjit nr. 9235/2004, i cili parashikonte mënyrat e disponimit të AKKP-së pas shqyrtimit në substancë të ankimit administrativ. Leximi i kësaj dispozite së bashku me nenin 18 të ligjit ofron mbështetje normative për dallimin e bërë nga Gjykata e Lartë, për sa kohë deklarimi i mungesës së juridiksionit administrativ nuk përbënte një nga mënyrat e zgjidhjes në themel të ankimit. Në këtë kuptim, qëndrimi i Gjykatës së Lartë për zbatueshmërinë e afatit ligjor 30-ditor mbështetet në një interpretim të ndërthurur të dispozitave të ligjit të posaçëm.

30. Në vlerësimin e Kolegjit, interpretimi i nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004 nga Gjykata e Lartë, i parë në kontekstin e kuadrit normativ të kohës dhe rrethanave konkrete të çështjes, nuk rezulton arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues. Për sa i përket argumentit të mbështetur në nenin 328 të KPC-së, ndonëse Gjykata e Lartë nuk i është referuar shprehimisht kësaj dispozite, arsyetimi i saj ka bërë të kuptueshme shkaqet për të cilat nuk ka pranuar humbjen e së drejtës së padisë, duke i dhënë përgjigje në thelb pretendimit të kërkuesit. Po kështu, parashikimi në nenin 328 të KPC-së i mundësisë për t'iu drejtues gjykatës në rast të mosshqyrtimi të ankimit administrativ brenda afatit ligjor nuk është *per se* i mjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin se mosushtrimi i kësaj mundësie kishte sjellë domosdoshmërisht humbjen e së drejtës së padisë në rrethanat konkrete. Në këtë kuptim, argumentet e kërkuesit nuk evidentojnë një interpretim ose zbatim haptazi të paarsyeshëm të ligjit nga Gjykata e Lartë, në atë masë që të cenojë garancitë e procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara. Po kështu, për sa kohë që pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është mbështetur vetëm në të njëjtat parregullsi procedurale, pa u parashtruar argumente autonome në mbështetje të tij, edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, pikat 1 e 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.